

VENDIM
Nr. 872, datë 11.11.2020

PËR MIRATIMIN E PLANIT TË SHPENZIMEVE, PËR VITIN 2021, TË ENTIT RREGULLATOR TË SEKTORIT TË FURNIZIMIT ME UJË DHE LARGIMIT E PËRPUNIMIT TË UJËRAVE TË NDOTURA (ERRU)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 1, të nenit 11, të ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996, “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e planit të shpenzimeve, për vitin 2021, të Entit Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura (ERRU), në shumën 51 919 550 (pesëdhjetë e një milionë e nëntëqind e nëntëmbëdhjetë mijë e pesëqind e pesëdhjetë) lekë, sipas pasqyrës nr. 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Ngarkohet Enti Rregullator i Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura (ERRU) për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe

ENTI RREGULLATOR I UJIT (ERRU)

PASQYRA NR. 1
PLANI I SHPENZIMEVE PËR VITIN 2021

Nr.	Emërtimi i shpenzimeve	Viti 2021 (lekë)
1	Pagat dhe shtesat e tjera	31,638,500
2	Sigurimet shoqërore dhe shëndetësore	5,294,200
3	Shërbime e furniturë	14,301,850
4	Investime	685,000
	TOTALI	51,919,550